

Asistenti i USHT-së, fiton çmimin e parë në Konferencën Shkencore të Budapestit

20 nëntor- Ndër faktorët që theksohen në analizë janë: niveli i hapjes së ekonomisë, niveli i shpenzimeve qeveritare, niveli i punësisë, zhvillimet në kursin e këmbimit dhe zhvillimet në koston e fuqisë punëtore. Rezultatet e punimit konfirmojnë gjithashtu relacione negative mes Investimeve të Huaja dhe nivelit të punë-zënies. Nga rezultatet 1% rritje në nivelin e punë-zënies, do të ndikojnë në 4.11% ulje të IHD –ve dhe rezultati kontradiktor, mund t'i atribuohet faktit që një pjesë e konsiderueshme e të punësuarve kanë aftësi të pamjaftueshme për aplikimin e performancës adekuate gjatë procesit të punës, duke mos kënaqur kërkesën e Investitorëve të Huaj. Kjo veçanrisht, vlen për rastin kur Investimet e Huaja krijohen përmes procesit të privatizimit ose blerjes së kompanive ekzistuese në vend.



Urim Hasipi

Mr. Bardhyl Dauti, asistent në Fakultetin Ekonomik në USHT-së mori pjesë në konferencën shkencore ndërkombëtare për hulumtuesit e rinj “FIKUSZ” 09 organizuar nga Universiteti i Budapestit të Hungarisë. Ne këtë konferencë ai u paraqit me punimin “Determinantet e Investimeve Direkte te Huaja në Maqedoni në periudhën kohore 1994 – 2008”. Në punimin shkencor, autori ka përdorur metodologji të avancuara ekonometrike të analizave të periudhave kohore të ko-integritimit dhe mekanizmit të vektorëve me korigjim të gabimit. Duke respektuar këtë qasje, në punimin në fjalë, për herë të parë është trajtuar relevanca empirike e hipotezave që nxirret nga literatura e investimeve të huaja në Republikën e Maqedonisë.

Autori nëpërmjet modelit ekonometrik që specifikon determinantet e Investimeve Direkte te Huaja, trajtoi disa nga faktorët të cilët reflektojnë zhvillimet në sektorin publik, sektorin privat dhe sektorin monetar, si ndër faktorët me të rëndësishëm për sjelljen e Investimeve Direkte te Huaja në vendin tonë.

Ndër faktorët që theksohen në analizë janë: niveli i hapjes së ekonomisë, niveli i shpenzimeve qeveritare, niveli i punësisë, zhvillimet në kursin e këmbimit dhe zhvillimet në koston e fuqisë punëtore. Rezultatet e punimit konfirmojnë gjithashtu relacione negative mes Investimeve te

Huaja dhe nivelit të punë-zënies.

Nga rezultatet 1% rritje ne nivelin e punë-zënies, do te ndikojnë në 4.11% ulje te IHD –ve dhe rezultati kontradiktor, mund t'i atribuohet faktit që një pjesë e konsiderueshme e të punësuarve kanë aftësi të pamjaftueshme për aplikimin e performansës adekuate gjatë procesit të punës, duke mos kënaqur kërkesën e investitorëve te huaj.

Kjo veçanrisht, vlen për rastin kur Investimet e Huaja krijohen përmes procesit të privatizimit ose blerjes se kompanive ekzistuese ne vend.

Me këtë punim asistenti Mr Bardhyl Dauti, prezantoi Fakultetin Ekonomik të Universitetit Shtetëror të Tetovës, me të cilin mori çmimin “Punimi më i mirë i Simpoziumit”

Kategoria: Lajme > Maqedoni

Publikuar: 21.11.2009 00:59

Burimi:

<http://www.tvkoha.tv/2522/asistenti-i-usht-se-fiton-cmimin-e-pare-ne-konferencen-shkencore-te-budapestit.html>
